Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**11.12.2023**	**18.12.2023**	**2023/0982**
Eksperti Teknik **Taulant Ahmeti**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **12.12.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.12.2023, OE “"Europrojekt Plus" SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0982, kundër njoftimit për rezultatet e projektit ideor lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Punimi i projektit kryesor dhe mbikeqyrjes profesionale per ndertimin e objektit te Gjykates Themelore ne Peje” me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 15/06/2023

Hapja e ofertave: 01/08/2023

Vendimi i AK-së: 20/11/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0982 i dt:05.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 i LPP-së; Neni 59 i LPP-së: Neni 60 i LPP-së; Neni 80 i LPP-së; Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik;

Neni 7 i LPP-së nr.04/L-042- Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

- Ky nen është shkelur pasi qe AK-ja pasi qe nuk i ka vleresuar te gjithë OE ne menyre parimore. AK ka perzgjedhur Komision te njejte edhe ne rivlersim i cili duhet te jete komision i ndryshem pasi komisioni i njete ne dy raste ka vleresuar (poentuar) ne menyre te ndryshme totalisht kontradiktore (e ka demantuar veteveten dhe ka bere shkelje te deklarates nen betim per cka e ka implikuar veteveten ne procedura penale.
  Zyrtari pergjegjes i prokurimit nuk eshte dashur te marre ne konsiderim Vleresimet nga i njejti komision me vleresime totalisht te ndryshme dhe skandaloze ne baze te **Neni 40 Rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik.** Në bazë të Nenit 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve -RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Ne situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do behet sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik 94 dhe duhet te përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim."

Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Oferta Teknike, kriteret e vlerësimit te projektit ideor

Tabela 1.

Kriteri	Pesha[2]	Metoda e vlerësimit

1	**Përmbajtja estetike** (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional)	30 %	$T = \frac{Tt}{Ts} \times <100x\%>^3$ [$T = \frac{Tt}{Ts} \times <100x\%>^4$]
2	**Përdorimi efikas i hapësirave** (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës)	30 %	
3	**Inovacioni** (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni)	25 %	
4	**Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth** (Harmonizimi mjedisor urban)	15 %	
		100 %	

Sqarim:

- **Oferta e peshuar me pike më së shumti nga juria sipas tabelës 1, automatikisht merr maximumin e pikëve ne tabelën 2 te oferta teknike e projektit.**
- **Ofertat e tjera llogariten ne proporcion sipas peshës ne raport me ofertën e pare.**

Kriteret e vlerësimit te ofertës për dhënie te kontratës

Tabela 2

Përshkrimi	Pikët
Oferta teknike (projekti)	60
Oferta financiar e projektit (çmimi)	20
Oferta financiar, Çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit për projektin e ofruar te gjykatës në Prizren	20
Totali i Pikëve	100

Me rastin e shpalljes të projektit tonë ideor si projekti ideor me më së shumti pike (projekti në vend të parë) filluam të besojmë se më në fund po troket ndërgjegjeja në vlerësim real jo vetëm pse është projeki ynë. Por kur pas ankeses se kompanis me shifër 2000 e njohur pë vet institucionin e Sekretariatit të këshillit Gjyqësor, si fitues i shumëfishtë i keti lloji të objekteve me zgjidhje jo inovative (kopje-të perseritur në kontinuitet), jemi të bindur se më të vërtetë kemi pasur të drejtë të mendojmë, dhe jemi mëse të bindur se jemi më të miret ne konkurrim. Po themi se është e njohur për vetë institucionin sepse e njëjta kompani fiton disa herë të njëjtin projekt me të njëjten zgjidhje (Apsurditet i llojit te vet) , e pa pranueshme , E NEVERITSHME.

Ne po mundohemi te jemi jashtëzakonisht të matur në përzgjedhjen e vërejtjeve në kuader të ketij proqesi, i cili ndoshta do të procedohet edhe në Hetuesi (varësisht nga ecuria

) dhe në të gjitha mediumet publike , elektronike , te shoqerisë civile dhe se nuk mund të paragjykojmë se deri ku do shkoj , por nuk e kemi ndërmend të ndalemi dhe të dorëzohemi deri sa ti fitojmë të drejtat tona legjitime **gjithnjë në suaza ligjore**.

Ne panelin e komisionit vleresues i vendosur nga vet Këshilli Gjyqësor i Kosovës me perberje:

1.Prof.Asoc.Dr.-Arkitekture M.D.----------

2.Ass.Dr.-Arkitekture-B.K.B. ----------

3.inxh.i Dipl. i Makineris.-A.Z. ----------

Në vlerësimin e parë Kompania jonë me shifër 7890 është vlerësuar me 23.3% të pikëve

Kompania e dytë me shifër 2000 është vlerësuar me .....16.5% te pikëve

Kompania e tretë me shifër 7878 është vlerësuar me .....13.9% te pikëve

Kompania e katert me shifër 1616 është vlerësuar me .....11.9% te pikëve

Kompania e peste me shifër 1183 është vlerësuar me .....8.9% te pikëve

Kurse pas ankesës së bërë nga kompania me shifër 2000 si duket ka ndodhë një **tërmet i magnitutes së lartë** në komisionin e njejtë të caktuar nga vetë institucioni i Këshillit Gjyqësor për vlerësimin e dytë, ku Kompania e dytë për nga vlerësimi fiton vendin e parë kurse kompania e fundit me vetem 8.9% te pikëve e poentuar në vlerësimin e parë të vlerësohet si e dyta në vlerësimin aktual me 64.04% të pikëve **(A nuk ka ketu vend për hetuesi ! , apo jo ?)** , kurse ne që ishim të parët te dalim në vendin e katërt për nga vlerësimi , për çka ata vetë duhet të japin llogari për atë që ka ndodhë para institucioneve përkatëse, perkujtojmë se komisioni vlerësues ka nënshkruar deklaratën nën betim me çka mbajnë përgjegjësi ligjore penale për moszbatim të deklaratës nën betim . **Mirëpo edhe vetë zyrtari përgjegjes i prokurimit duke pasur për bazë anomalitë dhe kontraditat dhe demantimit të vetëvetës të komisionit vlerësues kur në dy vlerësime ka zbatuar standarde të dyfishta të vlerësimit, është dashur të mos bejë shkelje ligjore dhe të mos merr për bazë një vlerësim të tillë të qoroditur dhe të refuzojë një vlerësim të tillë duke cituar** "Në bazë të Nenit 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve - RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Ne situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do behet sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik 94 dhe duhet te përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim."

Si është e mundur qe një komision me kaq experiencë shkollore të bie në grackën e një kompanie profiterie e cila me gënjeshtra , me të pa vërteta mundohet te fitoj përsëri , një kompani e cila ka fituar në Prizren me të njëjtin projekt me mungesë të zyreve të Zyrtarëve ligjor dhe Gjykatësve me çka mund të ju dëshmojmë me fakte si dhe me sistem konstruktiv të shkalleve dhe ashensorëve të pa vendosur në bodrum dhe shumë e shumë gabimeve tjera të cilat gabime nuk jane teknike si ato për të cilat është ankuar kompania në fjalë por gabime esenciale , fundamentale , (e pa pranueshme - DILETANTESKE).

Dhe në fund të kësaj hyrje të kesaj ankese ne edhe pas kërkimit që te na ipet vlerësimi se si eshte bërë , në bazë të kritereve te përcaktuara në DT, nuk na është dhënë , te cilin vlerësim besojmë se do ta kemi më vonë edhe ne edhe institucionet relevante .

Shtrohet pytja si është bërë vlerësimi për :

1. **Perzgjedhja estetike**

   Duhet te jemi te sinqertë se shijet personale të individëve të caktuar ndryshojnë , mirëpo të jenë verbërisht të ndryshme nuk na ka ndodhur . Aspektin estetik nuk ka nevojë të jeshë aq shumë profesionist dhe ta vlerësosh sepse flasin vet pamjet . Nuk është se me këtë padrejtësi po humb një apo disa persona , por po humb një qytet një objekt atraktiv , joshës , estetik dhe mbi të gjitha funksional , por që është më e rëndësishmja po humb vetë institucioni i drejtesisë (Gjykata) .

2. **Përdorimi efikas i hapësirave**

   Shtrohet pytja : Si mund të jetë një objekt me funksional me të njëjtat hapësira të destinuara sipas programit të projektimit sipas Dosjes se tenderit, kur objekti me shifër 7890 fitues në rastin e pare të vlerësimit, ka sipërfaqe : SIP. Neto = 4997.98m^2 dhe SIP.Bruto=5884.6m^2, kurse projekti me shifër 2000 të ketë SIP.Neto=5000.03m2 SIP.Bruto=6101.07m2 .Nga kjo del se siperfaqet e humbura tek projekti jonë janë 17.74% kurse tek projekti me shifër 2000 jane 22.02% . **Është apsurditet i llojit** të vet .
   Sa i përket aspektit funksional projekti me shifër 2000 qalon qysh ne hyrje , edhe pse hyrjet janë të veqanta të ndara ajo e qytetarëve dhe ajo e zyrtarëve , prapë se prapë ato janë aq afër sa gati të jenë te bashkuara ku distanca prej dyerve hyrëse të qytetarëve dhe dyerve të personelit gjyqesor është 9.2m ,(e pa tolerueshme) , byfe e stilit të hapur , koridore dhe sportele jashtëzakonisht të gjata etj me çka kemi humbje të konsiderueshme të sipërfaqeve.Por që është edhe më e dhimbëshme është fakti se personat me aftësi tëkufizuar nuk kan nyje sanitare as në katin e pare, as në të dytin, as në të tretin dhe as në të katertin me çka këtyre personave , kësaj kategorie ju pamunëdesohet aktiviteti në katet e cekura. TURP (e PA TOLERUESHME)

3. **Inovacioni**

   Me keqardhje duhet të themi se sikurse në dy piket e para edhe në këtë pikë e keni huqur jashtëzakonisht shumë sepse vetëm duhet të jesh së tepërmi i anshëm pë të bërë këtë vlerësim sepse e vërteta qëndron krejtësisht ndryshe , sepse në projektin tonë mund të themi se kemi inovacione (risi) të pa para në arkitekturën tonë të deritanishme , kurse projekti i propozuar për fitues me shifër 2000 është veqse një kopje e tija e një projekti të më hershem , pa asnjë risi , pa asnjë inovacion , pa asnjë …. Veqse një kub i thjështë me disa ngjyra koti.

Nën-kriterin : Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) I cili ne DT është vlerësuar me peshë 25%
Mos përdorimi i fugave të dilatimit në strukturë e cila i nënshtrohet ndikimeve sizmike , efektve të shkaktuara nga ndryshimet e temperaturave dhe tkurrjes së betonit si dhe efekteve të shkaktuara nga ulja e pabarabartë e tokës ndodhin plasaritje.Për konsruksionet e betonit të armuar gjatësia max për të minimizuar efektet e sipërpërmendura është L≤40m. Struktura e propozuar nga Shifra:"2000"
është >40m.Ndërsa projekti i propozuar nga kompania jonë e ka të përmbushur kriterin e fugës së dilatimit pasi struktura është ndarë në dy pjesë përmes fugës së dilatimit dhe dimensioni max është: <40m.Shtrohet pyetja logjike si mund të poentohet kompania e propozuar per dhenie të kontratës:me shifër"2000" në vend të parë

kur duhet të jetë e kundërta!!! Për nën-kriterin : Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) i cili ne DT është vlerësuar me 25% Aplikimi i fugave të dilatimit në ndërtim është vendimtar, veçanërisht për sa i përket qëndrueshmërisë dhe mbi të gjitha funksionalitetit të strukturës,për shkak të "punës" së strukturës.

4. **Përshtatjen adekuate me mjedisin Përreth**

Edhe në këtë pikë me keqardhje duhet të themi se duhet të turpërohen ata të cilët dhanë pikët në pikën e katërt që ka të bëj me **përshtatjen adekuate me mjedisin përreth**. Duhet të pyesim se me cilin kriter janë bërë keto matje , cilat janë pëparësitë e projektit fitues dhe cilat na qenkan dobësitë e projektit tonë. Pa modesti na duhet të ju themi se edhe këtu vlenë e kundërta, objekti ynë është ai i cili e plotëson hapësiren dhe shkrihet , kombinohet në hapësirë , kurse projekti me shifër 2000 është veqëse siq e cekëm edhe më herët një kub me disa ngjyra koti .

Objekti kopjues kub me ngjyra koti shifra"2000"

Zgjidhja inovative e Gjykates ne Peje e shifres “7890”

Ne këte pike duhet te ceket edhe nje element shumë shumë i rëndësishem ku :
Në dhënien e detyrë projektuese në fletën poseduese janë të cekura tri parcelat:
1. 00310-0
2. 00311-0
3. 00312-0
Të cilat nënkuptojnë se duhet të mirren në trajtim , ku parcela me Nr. 00310-0 Shifet se është e përcaktuar për hyrje në objekt e cila vie nga rruga kryesore , kurse shifra 2000 nuk e trajton fare parcelen në fjalë dhe propozon sipas dëshirës së vet rrugë në sipërfaqen e lirë komunale pa pasur asnjëe informatë për të dhe pa marrë asnjë pëlqim paraprak nga institucionet përkatëse për të , kurse rrugën brenda parceles së objektit të Gjykatës e ka shëndrruar në një pistë për gara për qytetarë E PA FALSHME



Situacioni i gjere parcelen katastrale Nr. 00310-0 **shifra “2000” nuk e ka trajtuar**



Situacioni i gjere parcelen katastrale Nr. 00310-0 **shifra “7890” e ka trajtuar**

Na duhet të përgjigjemi në ankesat e kompanisë me shifër 2000 drejtuar kompanisë 7890

1.Situacioni nuk është bazuar në gjendjen faktike (GËNJËSHTËR)

Është e kundërta , atë që e cekëm edhe më herët , kompania në fjalë nuk i ka marrë në trajtim parcelat të cilat na janë përcaktuar por i ka marrë sipas dëshirave dhe tekeve të veta. Prej nga i gjith ky guxim qe te trajtohjen parcelat jashta parceles se dhene kurse parcelat e dhena te mos trajtohen , KETE E DINI VETEM JU !!!

Një element shtese shumë i rëndesishëm ; ne Baza, prerje dukje dhe perspektiva nuk shifet fare gardhi kurse ne hollesira figuron gardhi i detajuar me dimensione të percaktuara. Shtrohet pyetje pse: Sepse ky projekt është i kompletuar me te gjitha fazat ku shifen edhe instalimet elektrike , termike,hidrosanitare e që per ne janë të vendosura ne mënyren më amatoreske të mundur, të shpërndara të pa futura në mbrendinë e mureve (të pa mbrojtura etj)

E PA PRANUSHME E PA TOLERUESHME.

2.Vendosja e hyrjes së qytetareve është e gabuar (VEREJTEJE AMATORESH)

Është e kundërta , ashtu siq e cekëm më herët: distanca nga dyert e qytetarëve dhe personelit është 9.2m , (DILETANTESKE) kurse tek ne qytetarët nuk kanë mundësi as të shifen me gjygjtarë dhe prokurorë.



Detaji(hollesira) e gardhit i detajuar me dimensione të percaktuara.nga Shifra "2000"

3.Pjerrinat nuk na qenkan ne rregull etj.
Kinse na paskan ndjenja për persona me aftësi të kufizuar kurse vet kompania ne fjale në të katër katet e sipërme nuk kanë nyje sanitare për këtë kategori . (TURP)

4.Pjerrina e bodrumit na qenka mu pranë parceles fqinjësore.
Duhet të ju bejmë me dije se ajo është vetëm pjerrinë dhe nuk është objekt dhe se ajo pjerrinë shkon vetëm deri në bodrum e jo sikurse rasti i tyre ku siq e cekëm edhe më herët:E ka berë një pistë për gara me makina për qytetarë Këtu vlenë të theksohet se nepërms asaj pjerrine kemi berë të mundur futjen e makinave të personelit për qfarëdo nevoje të munëshme si dhe të vet institucionit Policor i cili e bie të paraburgosurin me makinë drejtë në Bodrum pa u vërejtur fare dhe vendoset në hapësiren e të peraburgosurve ku në kuadër të asaj kthine ka shtratin për pushim , tualetin si dhe duarlaresin, kroin për te pirë uje apo për freskim eventual, kurse kompania me shifër 2000 nuk ka as tualet brenda kthinës se të paraburgosurve për kryerjen eventuale të nevojave fiziologjike e lëre më për pije dhe freskim.Si dhe i paraburgosuri duhet te hyj dhe te dal vetem e vetem nga hyrja kryesore e personelit. E PAPRANUESHME!!!

5.Vërehen trotuare të ndërprera, gjithashtu shirita gjelbërues etj.
Me të vërtet këtyre shpifjeve banale nuk ja vlenë as të ju përgjigjemi sepse është kategori e ulët njerëzore dhe profesionale.

6. Distanca e objektit nga parcela fqinjësore.
Duke marrë parasysh faktin se ky është projekt ideor këto distanca edhe mund të mbesin si të tilla pa asnjë lloj problemi por edhe mund të rriten varësisht nga sugjerimet e organeve pergjegjese.

7.Futja e makinave në parcele është ''gati'' në kendin 90 shkalle dhe se paska më tepër parkingje .
Me keqardhje duhet të ju themi se me të vërtetë po tregoheni jo professional , amatorë , me vetë formimin e ankesave , sinqerisht nuk po e dijmë se a është gabim të ketë më tepër parkingje se qe është kerkuar .!!!

ANALIZA E ZGJIDHJES FUNKSIONALE TË HAPËSIRAVE BRENDA OBJEKTIT

PËRDHESA;

1.Hapësirat e administratës na qenkan të shpërndara etj.
Sinqerisht na duhet të themi se ka nga ata profesionistë të cilët janë mësuar të punojnë në mënyrë shabllonike.Të mos e komentojmë me teper se na paska bashkëpunëtorë nga HAGA etj dhe nuk e njohin Projektimin modern (NO COMENT).

2.Holli hyrës na qenka i vogël.
Edhe projekti i tyre edhe projekti i jonë i kanë nga një parë dyer, si për qytetarë ashtu edhe për personel, kurse sipërfaqja e hollit është aq sa duhet te jetë sipas normave dhe standardeve të projektimit e jo sikurse tek rasti i komapnise me shifër 2000 ku ka humbje të sipërfaqeve te shumta apsolutisht të pa nevojshme.

3. Sigurimi është vendosur vetëm nga ana e qytetarëve etj.
Edhe në këtë pikë duhet të ju bejmë me dije se ky është PROJEKT IDEOR dhe si i tillë do ti nënshtrohet një kontrolli të detajuar nga organet përgjegjëse, dhe se ne kete rast pas dikutimeve te shumta dhe interesave te vet institucionit ateher vendoset nese është nevoja të shtohet apo edhe të hiqet ndonjë hapësirë

4.Bifeja është vendosur në zonën e qytetarëve e jo edhe të personelit etj.
A thua qytetarët të cilët në të shumtën e rasteve duhet të presin me orë dhe ditë të tëra nuk po u dashka të kenë një vend të dinjitetëshëm për tu freskuar dhe për pushim

fizik dhe psiqik, e këte të drejtë e paskan vetëm personeli i cili duhet te jetë në **vend pune** e jo ne bife dhe se i njëjti mund të porosisë edhe në zyre te vete.

5.Pulti është tejet i mangët etj.

Na vie keq per ju të cilet jeni mësuar të projektoni në mënyrë shabllonike ku kjo ose ajo duhet të jetë vetëm kështu dhe se nuk bënë ndryshe, ne ate pult për njëherit punojnë gjashtë punonjës e që për kapacitetin që ka ndoshta edhe janë shumë sepse në gjykatën e Prishtinës mund të jenë dy apo tri sportele aktive edhe jo me shumë, kurse tek ju është nje ''VAGON'' Kolonade e sporteleve . TMERR (E PA TOLERUESHME)

6. Zyra për pastrim ndodhet pranë hyrjes etj.

Duhet të ju pyesim se a është më mirë zyra për pastrim të jetë tek hyrja apo tek zyret e personelit si në rastin e juaj. Mundoheni që me gabimet e juaja ta njollosni tjetrin (MARRI).

7.Verejmë nje terasë gjatë tërë pjesës lindore, blla, blla, blla ....

Arkitektura nuk është vetëm KUBIZËM, Arkitektura ka lëvizje ka dinamikë , e jo sikurse në rastin e juaj një kub me do ngjyra koti edhe aq ma tragjike nuk keni as dije as profesionalizem as bashkëpunetorë që të ju sugjerojnë te beni nje zgjidhje tjetër përveq kopjimit. AMATORIZEM - DILENTANTIZEM

8. Dritaret e tualeteve pranë hyrjes etj.

Njeriu kur nuk ka ku të kapet mundohet edhe për fije kashte, shumë shumë e ulët , ato janë nyje sanitare vetëm për personel dhe ajo hyrje është vetëm për personel. nëse e keni kuptuar mirë, nese jo është arbitrare nga ana juaj.

KATI 1,2,3,4 (Vërejtjet e përseritura)

1.Katër zyre për gjykatës dhe bashkëpunëtorë kanë shtylla mu në mes të zyrës.

Kjo është ajo mendësia e juaj e projektimit në mënyrë shabllonike sepse; Duhet ta dini se në enterier shtyllat e tilla edhe sherbejnë për dekore të ndryshme funksionale për të cilat mund edhe të ju deshmojmë me projektimin e një kthine me shtyllë e cila shtyllë duhet të theksohet se apsolutisht nuk bënë pengesë në zhvillimin e aktiviteteve të personelit përkundrazi mundë të jetë edhe estetike.

2. Salla e Mesme e gjykimit ka formën e pa ''rregullt gjeometrike'' etj.

Qfarë shpifje e ulët , TURP JU QOFTË , nuk po e dijmë se a e keni shiquar projektin tonë apo të juajin kur e keni berë këtë vërejteje ku në disa prej sallave i keni disa kënde të vdekura .

3.Tek sallat e gjykimit nuk vërehen shkallët e ngritura etj.

Ne me keqrdhje edhe një herë duhet të ju bëjmë me dije edhe juve edhe panelit shqyrtues se ky është **PROJEKT IDEOR** dhe nuk është projekt ZBATUES sikurse i juaji i cili shifet qart se është i PARAFABRIKUAR, komplet projekti me të gjitha fazat (aj i Prizrenit) pak sa i modifikuar vetëm në pjesën ballore. E PA BESUESHME POR E VERTETE.

4.Dyert e sallave etj etj.

Edhe për këtë pikë vlenë e njëjta si në pikën 3. NO COMENT

5. Zyret për informim dhe logjistikë duhet të jenë blla,blla,blla,...

Ashtu siq e cekëm edhe më herët ju jeni prej atyre shabllonerëve të cilët nuk munden të dalin nga aty sepse kanë mbetur me mendesinë e vjetër, kopjimi si mjet makiavelist.

6. Zyra për prokurorë dhe avokatë është e ngushtë dhe e gjatë.

Ju lutem shiqojeni Sallën e juaj të Këshillimeve.

7. Ndriqimi i strehës së kulmit.....

Me të vërtet janë vërejtje aq jo serioze , aq jo profesionale sa që nuk kapërdihen , të mbesin në fyt dhe të zë trishtimi siq thoshte shkrimtari yn i njohur.Krejt në fund nuk na mbetur tjetër për të thënë veq se TURP TURP ju qoftë juve si kompani profitere. **VI.Kulmi i rrafshët nuk na qenka i preferuar për shkak të dështimeve të materialeve etj etj…**
A thua deri ketu është niveli i dijes se kesaj kompanie ''serioze'' PA KOMENT

2. Sa i përket kompanisë me shifer 1183 e cila herën e parë ishte e renditur në vendin e 5- të të fundit me vetëm e vetëm 8.9% te pikëve dhe tani pas rivleresimit kontestus është vlerësuar si e dyta me radhë është një SKANDAL në vetëvete dhe nuk don koment. Për këte kompani nuk dëshirojmë as te hargjojmë energji për shkak se flasin vet FAKTET.
Qysh në vitin e parë të studimeve mësohet RASTERI (Distanca nga një shtyllë deri në shtyllën tjetër) Sistemi KONSTRUKTIV. Dhe këtu vlejnërregullat BAZË . Rasteri për objekte banesore-Hotelerike është 60.0 cm , kurse rasteri tek objektet Shoqëore-Administrative është 80.0cm . Si është e mundur që një kompani te ketë kësi lloj SHKARAVINASH të rasterit, ku ne rasterin vertikal i ka këto rastere: 7.36 ; 7.49 ; 5.79 ; 6.03 nga katër rastere që të gjitha të ndryshme e qe asnjera nuk është e plotëpjetueshme me 80 . Kurse rasterat horizontal jane : 6.94 ; 6.48 ; 4.11 ; 8.55 ; 7.5 ; 7.5 nga pesë fusha te rasterit katër janë të ndryshme dhe të pa plotëpjestueshme me 80 . SKANDALOZE . Me këtë duhet ti alarmojmë edhe institucionet tona akademike, univerzitare (per emërimin e komisionit) se me qfarë profesorësh univerzitar kemi te bëjme, te mjerët ne si shoqeri se kush po na i edukon dhe shkollon fëmijet tanë.



Baza e katit të parë për shifrën 1183 ku shihen rasterat të cilët i “përpiu” komisioni vlerësues Universitar Skandaloz!!!

Kurse sa i përket organizimit te brendëshem të kthinave me të vërtet dhe shumë sinqerisht është për NO KOMENT , e TURPSHME , SKANDALOZE.
Të njëjten gjë mudemi lirisht ta themi edhe për ëeshtjen estetike Arkitektonike

17

1183

Perspektiva për shifrën 1183 e cila nga vendi i fundit "fluturoi" në vendin e dytë pas rivlerësimit SKANDALOZ!!!!!

Në fund mundemi vetëm të themi se i tërë proqesi pas ankeses së kompanisë me shifer 2000 është SKANDALOZ I TMERRËSSHËSM, TRISHTUES. Ju qoftë për nderë ''Komision i nderuar ''

Shkeljet në vendimin mbi refuzimin e ankesës së kompanisë me shifer 7890 nga AK

Pasi e lexuam refuzimin e ankesës sonë nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës krijuam përshtypje se është shkruar nga po e njëjta dorë si ajo e ankesës së shifrës 2000 (**Si duket mirë po ju shkoka muhabeti**) për qka ne nuk do të miremi me ta sepse me ta do te mirren gjykatat për dëshmit e ofruara.Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përgjigjur dhe është munduar për të trajtuar pikat vetëm sipas deshirës vetanake pa i trajtuar

sipas tyre ju kanë konvenuar , kurse te tjerat janë munduar të i anatemojnë . TURP JU QOFTË , Te mjerët ne ne qfarë rrethana po jetojmë si shoqëri. Por edhe një herë po e potencojmë se nuk do te ndalemi dhe nuk do të dorëzohemi dhe se nuk do te mundeni te na theni moralisht deri sa te arrijmë të i fitojmë të drejtat tona legjitime.

1.Vërtetohet vendimi i jurisë i dat.20.11.2023.....

Zyrtari përgjegjës që ka refuzuar kërkesën tonë për rivlerësim nuk ka ofruar dëshmi për formimin e komisionit për përgjigje për refuzimin e ankesës sonë pasi vetë si jurist nuk ka kredibilitet profesional për përgjigje arkitektonike dhe konstruktive(statike), si i tillë ka bërë shkelje të radhës pasi nuk ka emëruar komision (juri) profesionale, të kësaj fushe etj , apo është bërë përgjigja nga OE me shifrën 2000.

Oferta Teknike, kriteret e vlerësimit te projektit ideor

Tabela 1.

	Nën-kriteret	Pesha[5]	Metoda e vlerësimit
1	**Përmbajtja estetike** (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional)	30 %	T = Tt / Ts x <100x%>[6] [T = Tt / Ts x <100x%>[7]]
2	**Përdorimi efikas i hapësirave** (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës)	30 %	
3	**Inovacioni** (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni)	25 %	
4	**Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth** (Harmonizimi mjedisor urban)	15 %	
		100 %	

Këto kritere teknike i keni vendosur ju si institucion jo ne dhe ne piken 1 shkruan :

Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional)

Pa modesti duhet të them se si mund te jet një KUB I PA VLERA më i mire se një objekt dinamik shumë atraktiv për mjedisin ku vendoset si dhe për vetë institucionin , NJËANSHMERI E VERBËR nga ana e juaj. Në njëren anë i shifni qartëvertikalet kurse në anën tjetër jeni të verbër, në njërën anë thoni se shifra 2000 na paska përmasat e duhura kurse e jona kinse nuk i posedojka , shtrohet pytja si mund ti ketë një objekt me sipërfaqe të përafërt 1000m2 në bazë përmasat e duhura kurse tjetra me po aq sipërfaqe të përafert 1000m2 si dhe me dimensione te përaferta e të jetë njëra me përmasa të duhura e tjetra jo , për këtë njëanëshmëri tuaj të mirren GJYKATAT sepse ne ende mendojmë dhe jemi më së **te bindur se diku ka dhe do të ketë drejtesi.**

-Sa i përket Fasades gjysëm strukturale lirisht mund të vërtetohet se : nese objekti ynë na paska fasadë gjysëm strukturale atëherë qfarë na qenka fasada e komplet përdheses së objektit me shifër 2000 , NJEANSHMERI TOTALE.

2-Komunikimi i hapesirave për rreth .

E kemi elaboruar shumë qartë këtë pikë më lartë dhe nuk e shohim të arsyeshme që të i përserisim fjalët dhe argumentet tona ashtu siq e keni luajtur ju rolin e një Avokati mbrojtës të kompanisë me shifer 2000, NONSENS. Po e mbroni një hyrje dalje të pa kontrolluar me nje hyrje te qartë dhe saktë e destinuar. TURP TURP TURP

- Streha e objektit .

Edhe me këtët pikë le te mirren GJYKATAT në vërtetësinë e asaj që pretendon Këshilli Gjyqësor i Kosovës, cili na qenka ai inxhinier i Strukturave me aq dije tët KUFIZUAR profesionale për një pretendim të tillë , ndoshta edhe mund te jetët ndonjë "bashkëpunëtor nga HAGA" si e potencon SHIFRA 2000 (Pas qasjes ne dokumenta zyrtarë verejtëm se shifra 2000 ka shënuar në ballinë të projektit ideor kinse ka bashkëpunëtorë nga HAGA???), ku i dihet , me të vëtrtetët e NEVERITSHME .

- Në përdhesët qytetaret kan qasje në zyret administrative etj .

Nës përdhesë është vetëm një zyre për referent dhe për financa , zyre të cilat nuk bien ndesh me qytetarët kurse në katet tjera është vetëm një zyre për përkthyes e cila prapë nuk bie ndesh me qytetarë , pra pretendimet e **KGJK**-se janë plotësisht të pa bazuara dhe të pa sinqerta , kurse sa i përket zyres së Kryetarit ne mendojmë se Kryetari është mirë te ketë lidhje direkte edhe me qytetarë për evidentimin e ndonjë shqetësimi eventual të tyre edhe pse ne rastin tonë Kryetari ka qasje edhe përmes hyrjes zyrtare përmes sallës se Kolegjiumit **të cilën shifra 2000 nuk e ka fare ku në vend të saj vendos sallë të KONFERENCAVE për 30 Gjyqëtarë (Apsurditet) pa qene fare e kërkuar, të cilen ju si autoritet fare nuk e evidentoni.**

-Nuk ka Bife nga ana e Gjyqëtarëve , Duhet të jetë e kundërta.

Pretendimi i njejtë sikurse i shifres 2000 . NO COMENT. Edhe këtë pikë e kemi elaboruar në detaje më lartë.

-Pozicioni i të peraburgosurit ëhtë vendosur në pozicion jo të duhur dhe jo me hyrje të veqantë.

E pa vërtetë , e tmerrëshme, sipas jush duhet të jetë e vendosur vetem e vetem sipas shifres 2000 dhe nuk ben asesi te jetë ndryshe, sinqerisht NIVEL I ULËT PROFESIONAL I JUAJI.

-Janë vendosur më shumë vend parkime se që janë kërkuar .

Na vie keq por të jemi të sinqerë edhe pse po mundohet **KGJK** me mish e shpirt ta nxjerr sinqerë edhe nga balta shifrën 2000, na besoni se nuk po e luajnë rolin e mirë të një avokati mbrojtës. Të njëjtat pretendime i kanë edhe shifra 2000. Ky pretendim është sqaruar më detajisht në pjesën më lartë.

Te organizimi i Sallave arsyetimi i penalizimit është si vijon:

-Hyrja e gjyqëtareve është e veqantë por përdoret edhe për të paraburgosur .

SPEKULIM , SHTREMBËRIM I TË VERTETES , E verteta është se egziston vetëm një sallë e madhe e gjykimit dhe se i paraburgosuri e ka hyrjen e vetë afër sallës së madhe të gjykimit ku ndërmjet veti kan koridorin lidhës. Kurse në rastin e shifres 2000 kemi zyre të tepërta për të cilat juve nuk ju bien ne sy . Sipas programit dhe hapësirave të kërkuara askund nuk figuron (nuk është kërkuar) hapësira për **,Zërim , Sekretari gjyqesor , Avokati , Dëshmitari i mbojtur** . Të gjitha këto për ju na qenkan të tolerueshme kurse parkingjet na qenkan të tepërta. Nëse pretendimi i juaj është se i paraburgosuri nuk na paska hyrje te veqantë ne OBJEKT, këtu sinqerisht na duhet të ju themi se jeni treguar shumë të pa skrupullt më gënjeshtrat e juaja spekulative, sepse, në zgjidhjen tonë i paraburgosuri hyn në objekt me makinë të institucioneve përkatëse përmes BODRUMIT jashtë syve të

mediumeve dhe qytetarëve kurse tek ju hyrja e te paraburgosurve është vetëm e vetëm përmes hyrjes së personelit gjyqesor . TURP

-Depo të provave nuk ka fare.

Prapë na duhet të ju themi SPEKULIM , Nuk ka sepse nuk është kerkuar në DT , ju lutem. Të gjitha pretendimet tjera të kesaj pike janë aq të uleta sa që na vie turp edhe te ju pergjigjemi ashtu edhe siq e meritoni, te thoni se mungon ulësja për persona të hendikepuar në Sallën e gjykimit kjo me të vërtetë ska koment kur dihet se kjo kategori është e mëshiruar me karrigen e vet dhe se këta persona vendosen në vijën e parë të sallës , kurse kompania me shifrën 2000 në **kater kate** nuk ka fare **TUALET** për kët kategori me qka ju pamundësohet apsolutisht qfardo lloj aktiviteti të gjithë atyre të kësaj ketegorie dhe juve nuk ju bënë fare përshtypje , SHUMË E QUDITSHME???

3	**Inovacioni** (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni)

Pretendimet e KGJK-së janë TENDENCIOZE SPEKULATIVE se inovacioni na qenka optimizimi i efikasitetit të energjisë, përfshirjen e burimeve të rinovueshme, është asgjë tjetër veq se një SPEKULIM I KULLUAR, i cili nuk pin ujë , Pika 3 te cilën ju e keni vendosur thotë: **Inovacioni** (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) , Kusht të cilin ne e kemi arritur me 100% kurse shifra 2000 totalisht dështon dhe nuk ka lidhje me pretendimet e juaja. Kjo pikë ka peshën 25% ne krteret për dhenien e kontratës. Edhe për këtë pikë do te mirren Gjykatat.

Duhet të ju bëjme me dije se pas përzgjedhjes së projektit **TONË** me më së shumti pike si projekti me i mire , me kërkesen e vet institucionit për energjinë e ripërtritshme jemi të gatshëm te ju ofrojmë qfardo lloj shërbimi por duhet dhe vlenë të theksohet se ky tani për tani është vetëm e vetëm projekt IDEOR, e jo Projekt ZBATUES siq pretendoni ju.

Kur flitni per kompaninë me shifër 2000 mundoheni ta arsyetoni se të gjitha mangësit e projektit Ideor do të plotëohen me projektin kryesor të cilen gje asnjeherë nuk e potenconi , nuk e thoni për kompaninëme shifer 7890 , ashiqare PRETENDIM TENDECIOZ i hartuar nga e njejta dorë e njëjta mendësi.

4.Përshtatja adekuate në terren.

Pa deshte te hyjmë më në detaje dhe ta elaborojmë këtë pretendim ashtu si edhe pretendimet tjera më lartë, shifen nga "HENA" , se janë apsolutisht të një anshëm dhe diskriminues dhe se edhe këtë pikë e kemi elaboruar më lartë më hollësisht. Jane marrë dhe trajtuar nga ana e kompanisë 2000 parcelat të cilat nuk i ka pasur për trajtim (Rruget në dy drejtime) kurse ato të cilat janë dhënë për tu trajtuar ju si KGJK nuk i keni përfillë . Me një fjalë **SKANDALOZE**

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professiona	**Dësmia e kërkuar dokumentare**
Operatori ekonomik ofertuesi që oferton duhet te posedoië inxhinier me përvoje së paku pese (5) viecare ne dreitimet: 1. Së paku një (1) Inxhinier Ndërtimtarisë I Diplomuar ose Një Bachelor me Master i Ndërtimtarisë; 2. Së paku një (1) Inxhinier i Arkitekturës i Diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Arkitektures; 3. Së paku një (1) Inxhinier i makinerisë i diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Makinerisë; 4. Së paku një (1) Inxhinier i Elektroteknikes i Diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Elektroteknikes; 5. Së paku një (1) Inxhinier i Gjeodezisë i diplomuar Ose Një Bachelor me Master i Gjeodezisë. Dësmia e kërkuar dokumentare	1.Diplomat e Inxhinierëve duhet te jene te (Noterizuara data e Noterizimit nuk duhet te jetë më shume se Nëntëdhjetë (90) dite kalendarike nga data e publikimit këtij aktiviteti - Njoftimit për Kontratë). 2.Te prezantohen CV-it, përvoja e punës për secilin Vec e Vec; 3. Te prezantohen kontratat e punës, Ose para kontrata - marrëveshje në emër të projektit me ofertuesin - operatoren ekonomik si dhe te jen të (Noterizuara data e Noterizimit nuk duhet te jetë më shume se Nëntëdhjetë (90) dite kalendarike nga data e publikimit këtij aktiviteti Njoftimit për Kontratë).
Operatori ekonomik Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontratë apo kontrata të përfunduara te projekteve ndërtimore dhe te mbikëqyries se punimeve ndërtimore ne tri (3) vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë. vlera e përgjithshme monetare e tyre duhet te jetë jo më e vogël se 80,000.00 €.	Lista e kontratave te realizuara se bashku me Referenca ose Raporte te Pranimit.
Ofertuesi – Operatori ekonomik Kompania Projektuese në ofertë duhet të paraqes (planin dinamik) afatin e dorëzimit Punimi i projektit kryesor për objektin e Gjykatës Themelore Pejë.	Deklaratë të Nënshkruar edhe e Vulosur ku Ofertuesi Kompania Projektuese deklaron se kohëzgjatja e dorëzimit e projektit kryesor te kompletuar sic është kërkuar ne D.T., specifikat teknike ANKESI 1. Punimi i projektit kryesor për objektin e Gjykatës Themelore Pejë dorëzohet ne dite kalendarike nga urdhëresa e menaxheri te kontratës nga Autoritetit Kontraktues

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

09 / 1823
27. 11. 23

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAIT

Datë: 27.11.2023
Nr.Ref./ZP/180/2023

Bazuar Ligjit Prokurimit Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 108/A pika 2, dhe Rregullave për parashtrimin e ankesave te miratuara nga KRPP, për Prokurim Publik, sipas Kërkesës për Rishqyrtim nga Operatori Ekonomik me Shifrën – Kodin e dorëzimit te ofertës – projektit **7890**, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim, me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

V E N D I M
MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM SI TË PABAZUAR

I.*Refuzohet ne Tërësi kërkesa për Rishqyrtim* për Operatori Ekonomik me Shifrën – Kodin e dorëzimit te ofertës – projektit **7890**, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim, me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

II. ***Vërtetohet*** vendimi i jurisë i datës **20/11/2023** bazuar nenit 80 LPP-se dhe Rr.Nr.00/2022 për P.P, neni 55, për aktivitetin e prokurimit me titull: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, ri vlerësim me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, dhe numër te brendshëm: 33300/023/017/223.

III. ***Autorizohet*** Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, te respektoj Vendimin e jurisë për procedurat e prokurimit sipas LLP-se, nenit 80 dhe RR.nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

IV. ***Obligohet*** Autoriteti Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, qe kërkesën për ri shqyrtim është Pa Bazuar të ja komunikoj parashtruesit te ankesës dhe te gjitha palëve te interesuar.

V. ***Vendimi*** i jurisë për Autoritetin Kontraktues: Sekretariati Këshilli Gjyqësor të Kosovës, është i detyrueshëm. Dosja e tenderit: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, i publikuar me date ***15.06.2023***, Tek **Pjesa II.Fleta e të dhënave të tenderit (FTD), Udhëzimet e tenderuesit; Përshkrimi i nenit : Vendimi i Jurisë; Neni 5.1 Vendimi i Jurisë është detyrues për autoritetin kontraktues: Po ☒ Faqe 9 . D.T.**

VI. ***Vendimi*** hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"Europrojekt Plus" SH.P.K.**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së kundër vendimit të AK-së, duke ngritur disa pretendime, ku sipas tyre AK ka bërë disa shkelje gjatë procedurave të vlerësimit. Përgjigjet në pretendimet e ngritura janë si më poshtë. Pretendimet e mëposhtme të cilat kanë të bëjnë me aspektin teknik, për të njëjtat është përgjigjur eksperti teknik.

Pretendimi Ankimor 1:

Sipas pretendimit ankimor 1 OE ankues ka shfaqur verejtjet si më poshtë për të cilat Eksperti ka bere vlerësimin e fakteve dhe sqaron se:

Tenderëve -RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pika 40.13 Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Ne situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do behet sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik 94 dhe duhet te përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim."

Sipas ekspertit shqyrtues, dispozita e Rregullores në të cilën është thirrur OE ankues ka të bëjë me rastin kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk e pranon rekomandimin e komisionit të vlerësimit, atëherë ai mund të formoj komision të ri për rivlerësim apo mund të nxjerr vendim

përfundimtar ashtu siç e thotë edhe rregullorja. Mirëpo, në rastin kur lënda kthehet në rivlerësim me vendim të OSHP-së në asnjë dispozitë ligjore nuk përmendet fakti se AK duhet të formoj komision të ri të rivlerësimit sapo lënda të kthehet në rivlerësim me vendim nga OSHP. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi Ankimor 2:

Në pretendimin ankimor 2 OE ankues ka shfaqur verejtjet si me poshte per te cilat Eksperti ka bere vleresimin e fakteve dhe sqaron se:

Neni 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Oferta Teknike, kriteret e vlerësimit te projektit ideor

2.1 PERZGJEDHA ESTETIKE

1. **Perzgjedhja estetike**

Duhet te jemi te sinqertë se shijet personale të individëve të caktuar ndryshojnë , mirëpo të jenë verbërisht të ndryshme nuk na ka ndodhur . Aspektin estetik nuk ka nevojë të jeshë aq shumë profesionist dhe ta vlerësosh sepse flasin vet pamjet . Nuk është se me këtë padrejtësi po humb një apo disa persona , por po humb një qytet një objekt atraktiv , joshës , estetik dhe mbi të gjitha funksional , por që është më e rëndësishmja po humb vetë institucioni i drejtesisë (Gjykata) .

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 2.1:

Kriteri për zgjidhjen estetike parimisht është në përgjegjesinë e komisionit vlerësues të cilit edhe i është besuar puna nga AK si juri profesionale dhe vlerësimi estetik kryesisht është i natyrës subjektive dhe ne diskrecionin të anëtareve te jurisë profesionale, gjithnjë në pajtim me kriteret e dhëna në FDT.

Përdorimi i fasadës strukturale ne disa pjesë të objektit nga OE-ankues e cila sipas FDT-së nuk është e pranueshme ka reflektuar me të drejtë në poentim nga juria vlerësuese për këtë kriter. Gjithashtu, mungesa e detajeve të stehës së kulmit e paraqitur në dukje të fasadave por që mungon në prerjet dhe bazën e kulmit ka ndikuar me arsyeshmëri te plotë në poentim.

Megjithatë duhet theksuar se fasada e propozuar me "shumë thyerje/lëvizje" e paraqitur në project ideor nuk mund të ndikoj aq shume në aspektin e sigurisë dhe humbjen e energjisë, derisa ne anen tjeter kontribon në mënyre esenciale në paraqitjen estetike të objektit që lidhet drejpërdrejt me kriterin e dhënë- estetik . Në këtë rast OE ankues është penalizuar pa te drejte në poentim, e ky fakt kuptohet nga përgjegjia e kërkesës për ri-shqyrtim nga AK-ja. Eksperti teknik konsideron se pretendimi është pjeserisht i bazuar.

2. **Përdorimi efikas i hapësirave**

Shtrohet pytja : Si mund të jetë një objekt me funksional me të njëjtat hapësira të destinuara sipas programit të projektimit sipas Dosjes se tenderit, kur objekti me shifër 7890 fitues në rastin e pare të vlerësimit, ka sipërfaqe : SIP. Neto = 4997.98m^2 dhe SIP.Bruto=5884.6m^2, kurse projekti me shifër 2000 të ketë SIP.Neto=5000.03m2 SIP.Bruto=6101.07m2 .Nga kjo del se siperfaqet e humbura tek projekti jonë janë 17.74% kurse tek projekti me shifër 2000 jane 22.02% . **Është apsurditet i llojit të vet** .
Sa i përket aspektit funksional projekti me shifër 2000 qalon qysh ne hyrje , edhe pse hyrjet janë të veqanta të ndara ajo e qytetarëve dhe ajo e zyrtarëve , prapë se prapë ato janë aq afër sa gati të jenë te bashkuara ku distanca prej dyerve hyrëse të qytetarëve dhe dyerve të personelit gjyqesor është 9.2m ,(e pa tolerueshme) , byfe e stilit të hapur , koridore dhe sportele jashtëzakonisht të gjata etj me çka kemi humbje të konsiderueshme të sipërfaqeve.Por që është edhe më e dhimbëshme është fakti se personat me aftësi tëkufizuar nuk kan nyje sanitare as në katin e pare, as në të dytin, as në të tretin dhe as në të katertin me çka këtyre personave , kësaj kategorie ju pamunëdesohet aktiviteti në katet e cekura. TURP (e PA TOLERUESHME)

Përgjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 2

Çështja e organizimit të hapesirave dhe orientimit të tyre i takon AK-së permes komisionit profesional te vleresoj se cila eshte zgjidhja me e mire funksionale, por gjithnje ne linjë me kërkesat e specifikuara në FDT. Konsiderioj se pretendimi i OE ankues ne raport me shfrytezimin e hapësirave bruto dhe neto është i pabazuar. Sepse perveq raportit te thjeshtë bruto/neto të hapësirave per objekt të natyrës se tillë me rendësi te veçantë eshtë edhe alokimi dhe organizimi i hapësirave që do të rezultojnë me kthina funksionale per gjykatën e cila duhet të vlerësohet nga juria profesionale. Pretendimi i OE ankues ne kete rast konsideriohet i pa bazuar.

Pretendimi në lidhje me pozicionin e dy hyrjeve në objekt i paraqitur nga OE fitues, Nga raporti i vlerësimit vërejme se edhe OE fitues nuk është vlerësuar me 100% pikë në kriterin e përdorimit efekas të hapsirave dhe OE ankues eshte vlerësuar më lart për këtë qështje specifike, dhe sa I peket ketij aspekti OE ankues ka marrë pikë më shumë. Ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi lidhur me stilin e byfesë, duhet theksuar se edhe pse kerkesa per llojin e bufesë nuk është specifikuar ne FDT, gjatë vlerësimit është në kompetencën e AK përmes jurisë profesionale të vlerësojë apo poentojë ne lidhje me propozimet për vendosjen dhe stilin e byfesë. Pretendimi konsideroj se është i pa bazuar.

Pretendimi se nga OE fitues janë paraqitur koridore dhe sportele jashtëzakonisht të gjata,

konsideroj se nëse OE fitues i është përmbajtur të gjitha kërkesave të përcaktuara ne FDT sa i përket destinimit të kthinave dhe shfrytëzimit racional i hapësriave, AK vendos përmes komisionit të vlerësimit për poentimin adekuat ne lidhje me kete kriter (përdorimi efikas i hapësirave). Eksperti Teknik konsideron se pretendimi është i pabazuar, pasi edhe ne projektin e propozuar nga OE ankues ka korridore te gjata per qasje ne gjykata.

OE ankues pretendon se OE fitues nuk ka vendosur nyjet sanitare për përsona me aftësi të kufizuar në të gjitha katet, edhe pse kjo ceshtje mund të zgjidhet edhe qartësohet edhe në fazën e projektit kryesor pasi që ceshtja e qasjes së personave me aftësi të kufizuara është kërkesë ligjore. megjithatë është dashur të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe poentimit. Konsideron se pretendimit është pjeserisht i bazuar.

Ne kërkesën për rishqyrtim AK me të drejtë ka potencuar edhe mangësite tjera që i ka vërejtur në projektin ideor të OE ankues sic janë: qasja ne disa zyra administrative nga ana e qytetarëve, mungesa e destinimit per disa nga zyrat, Zyra e Kryetarit te gjykates ka qasje nga hapësira e publikut, pika e sigurmit vetem ne anen e hyrjes per qytetar e që mungon te hyrja per zyrtar, mungesa e hapesires per keshillim 5 stacione pune sipas kekerkes specifike ne (FDT), nuk ka qeli per te burgosur ne sallat e gjykimit (mesme), parabugosuri hyn nga dera e cila eshte prapa shpines se gjyqtarit, pozicioni i parkingut komplet ne anen e kundert me hyrjen zyrtare dhe numri me i madh i parkingjeve krahasuar me kerkesen specifike ne FDT.

Sidoqofte disa nga penalizimet qe jane permendur ne kërkesen per rishqyrtim ishte dashur te vlejne edhe per OE fitues, pasi jane te meta qe i percjellin dy projektet si: Te burgosurit transferohen permes korridoreve dhe ashensoreve te cilat I perdorin gjykatesit dhe personeli i gjykates, mungesa e pjeses se parapare per kontroll me magnetometer, (OE ankues se paku ka paraqitur kontroll te hyrjes (turnstile door) te pjesa e hyrjes per qytetar) , pozicioini hapesires per te paraburgosur pa hymje te vecante (shfrytezohet hyrja e njejte me gjykatesit), vendi ku do te qendroje sigurimi kur I paraburgosuri eshte ne qeli te sallat e gjykimit etj.

Gjithashtu sa i perket organizimit te sallave te gjykatës poentimi gjithsesi ka reflektu disa nga mangesite qe jane evidentu edhe nga Eksperti teknik si: dhoma te avokateve per keshillimeve me qasje nga publiku mungon edhe pse si kërkesë është e paspecifikuar ne detyren projektuese ne FDT, dhe dy çeshtje minore qe mund lehtësisht të rregullohen gjate fazës së projektit kryesor si podium I te njejtit nivel me pjesen e qytetareve, hapja e dyerve te salles behet nga brenda.

Sidoqofte edhe ketu disa nga penalizimet do te duhej te vlenin edhe per OE fitues : Hyrja e gjyqtareve eshte e vecante por perdoret edhe per hyrjen e te paraburgosurit (e palejueshme) (te salla e mesme), depo te provave nuk ka fare ne kompozicionin e salles (nuk eshte kerkuar ne FDT dhe nuk ka as te projekti i OE fitues), zone e ndare ne parmake mes publikut dhe

pjeses zyrtare, nuk ka hyrje te veqante per te paraburgosurit shfrytezon hyrjen e njejte me gjykatesin, nuk ka ulese per persona te hendikepuar brenda salles se gjykimit, pozicion i vecante i uljes se te burgosurit dhe sigurimit fizik gjate senacave (dmth uleset nuk jane te ndara ne zonen e te akuzuarve, avokateve , sigurimit etj.nga pjesa e publikut, etj.

Mungesa e pjeses narrative të vlersimit nga ana e jurisë profesionale pamundëson që të kuptohet qartë vlerësimi apo poentimi i OE në lidhje me këtë kriter. Eksperti teknik konsideron se pretendimi është pjeserisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 3- Invovacioni

3. **Inovacioni**

Me keqardhje duhet të themi se sikurse në dy piket e para edhe në këtë pikë e keni huqur jashtëzakonisht shumë sepse vetëm duhet të jesh së tepërmi i anshëm që të bërë këtë vlerësim sepse e vërteta qëndron krejtësisht ndryshe , sepse në projektin tonë mund të themi se kemi inovacione (risi) të pa para në arkitekturën tonë të deritanishme , kurse projekti i propozuar për fitues me shifër 2000 është veqse një kopje e tija e një projekti të më hershem , pa asnjë risi , pa asnjë inovacion , pa asnjë …. Veqse një kub i thjështë me disa ngjyra koti.

Nën-kriterin : Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) I cili ne DT është vlerësuar me peshë 25%
Mos përdorimi i fugave të dilatimit në strukturë e cila i nënshtrohet ndikimeve sizmike , efektve të shkaktuara nga ndryshimet e temperaturave dhe tkurrjes së betonit si dhe efekteve të shkaktuara nga ulja e pabarabartë e tokës ndodhin plasaritje.Për konsruksionet e betonit të armuar gjatësia max për të minimizuar efektet e sipërpërmendura është L≤40m. Struktura e propozuar nga Shifra:"2000"
është >40m.Ndërsa projekti i propozuar nga kompania jonë e ka të përmbushur kriterin e fugës së dilatimit pasi struktura është ndarë në dy pjesë përmes fugës së dilatimit dhe dimensioni max është: <40m.Shtrohet pyetja logjike si mund të poentohet kompania e propozuar per dhenie te kontratës:me shifër"2000" në vend të parë

kur duhet të jetë e kundërta!!! Për nën-kriterin : Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) i cili ne DT është vlerësuar me 25%
Aplikimi i fugave të dilatimit në ndërtim është vendimtar, veçanërisht për sa i përket qëndrueshmërisë dhe mbi të gjitha funksionalitetit të strukturës,për shkak të "punës" së strukturës.

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 3:

Pas analizimit të pretendimit 3 dhe rishikimit të projektit eksperti teknik konsideron se: Sipas FDT-së kriteri për inovacion kufizohet në nënkritere (zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni) dhe nuk përfshinë zgjidhjen inovative sa i përket aspektit të

teknologjive të reja, shfytëzimit të burimeve alternative të energjisë, efikasitetit energjetik të objektit, reciklimit te ujit sanitar apo edhe shfrytezimit te ujrave atmosferike. Konsideroj se në këtë aspekt komisioni i vlerësimit gjatë poentimit është dashur të këtë kujdes dhe të vlerësojë vetëm inovacionet në lidhje me sistemin konstruktiv të objektit sipas nenkritereve ne FDT e që mund të jetë përdorimi i materialeve më të lehta apo parafabrikate të cilat shkurtojnë kohën e ndërtimit.

Eksperti teknik konstaton se për këtë kriter të gjithë OE është dashur të vlerësohen me pikë të barabarta minimale, sepse asnjë nga OE nuk është se ka sugjeruar përdorimin e ndonjë sistemi inovativ për konstruksionin e objektit, por kanë parashikuar sistem tradicional të strukturës së objektit beton-arme. Ky pretendim **është i bazuar.**

Pretendimi për mos përdorimin e fugave të dilatimit në structure nga OE fitues, shpjegojmë se përdorimi i fugave të dilatimit paraqet inovacion kjo nuk qëndron sepse përdorimi i fugave të dilatimit rrjedh nga këkesat sipas standardeve të projektimit për konstruksionet e betonit. Gjithashtu, mungesa e paraqitjes së fugës së dilatimit nga OE fitues nuk mund të penalizohet sepse ky detal është një ceshtje që mund të zgjidhet gjatë projektimit ne fazën e projektit kryesor- llogarisë statike. Eksperti Teknik vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar

Pretendimi ankimor 4- Përshtatjen adekuate me mjedisin Perreth

4. **Përshtatjen adekuate me mjedisin Përreth**

Edhe në këtë pikë me keqardhje duhet të themi se duhet të turpërohen ata të cilët dhanë pikët në pikën e katërt që ka të bëj me **përshtatjen adekuate me mjedisin përreth**. Duhet të pyesim se me cilin kriter janë bërë keto matje , cilat janë pëparësitë e projektit fitues dhe cilat na qenkan dobësitë e projektit tonë. Pa modesti na duhet të ju themi se edhe këtu vlenë e kundërta, objekti ynë është ai i cili e plotëson hapësiren dhe shkrihet , kombinohet në hapësirë , kurse projekti me shifër 2000 është veqëse siq e cekëm edhe më herët një kub me disa ngjyra koti .

Ne këte pike duhet te ceket edhe nje element shumë shumë i rëndësishem ku :
Në dhënien e detyrë projektuese në fletën poseduese janë të cekura tri parcelat:
1. 00310-0
2. 00311-0
3. 00312-0
Të cilat nënkuptojnë se duhet të mirren në trajtim , ku parcela me Nr. 00310-0
Shifet se është e përcaktuar për hyrje në objekt e cila vie nga rruga kryesore , kurse shifra 2000 nuk e trajton fare parcelen në fjalë dhe propozon sipas dëshirës së vet rrugë në sipërfaqen e lirë komunale pa pasur asnjëc informatë për të dhe pa marrë asnjë pëlqim paraprak nga institucionet përkatëse për të , kurse rrugën brenda parceles së objektit të Gjykatës e ka shëndrruar në një pistë për gara për qytetarë E PA FALSHME

Përgjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 4

Në pretendimin 4 përshtatja me mjedisin përreth, OE ka paraqitur ankesë duke hamendësuar se me cilin kriter është bërë matja për dhënien e pikëve, mirëpo duhet të theksojmë se OE ankues për këtë kriter është poentuar me pikët maksimale, ashtu si edhe tre ofertuesit e tjerë andaj ky pretendim nuk qendron, edhe pse në përgjegjen e AK-s në kërkesen për rishqyritm

elaborohet arsyeja e diferencës në poentim në lidhje me OE fitues, edhe pse realisht janë dhënë pikët e njejta maksimale.

Pretendimi në lidhje me përdorimin për qasje në objekt përmes paracelave të cilat janë dhënë në detyrën projektuese, nga analizimi i projektit vërehet se OE fitues ka bërë qasjen në objekt duke shfrytëzuar parcelën fqinjë e cila parcel nuk është pjesë e projektit, por ne realitet ajo shfrytezohet si rruge sekondare për qasjen ne objektet tjera perreth (parcelat janë të përcaktuara tek FDT). Te situacioni i ngushtë i paraqitur nga OE fitues (fq. 4) kemi vërejtur se ne kete situacion është paraqitur nje rrugë e gjërë dhe e drejtë e cila parashihet te ndertohet në parcelën fqinjë dhe nuk është pjesë e paracelave të prezantuar nga AK përmes FDT-së në detyrën projektuese. Gjithashtu menyra e paraqitjes duket se nuk është shume reale, kjo sepse në paraqitjen grafike te situcionit te ngushte jane fshehur objektet ekzistuese qe mund te interferojne me rrugen e paraqitur. Eksperti Teknik në këtë pikë konsideron se pretendimi është argumentuar dhe ky fakt është dashur të merret parasysh gjatë poentimit të projektit në fazën e vlerësimit. Konsideroj se pretendimi është i bazuar.

Pretendime tjera ankimore

Në ankesën e drejtuar OSHP-së, OE ankues i është përgjigjur edhe pretendimeve të OE me shifer 2000 drejtuar OE 7890- ankues. Mirëpo këto pretendime të OE 2000 janë shqyrtuar nga Eksperti Teknik në raportin e datës 11.09.2023 numer të lëndës 2023/0607, me të cilin raport edhe është propozuar që lënda të kthehet në Rivlerësim nga AK. Rrjedhimisht, pretendimet e OE ankues në këtë rast nuk mund të ri-shqyrtohen.

Mendimi i Ekspertit Teknik

Sqarime shtesë

Procesi i konkursit për projektim është i rregulluar sipas LPP dhe Rregullorës per Prokurim Publik 001/2022, e cila përcakton se në cilat raste bëhët p*ërdorimi i konkursit për projektim,* pika *55.7 Procedura nuk mund të përdoret për furnizimin e shërbimeve (përveç planit ose vet projektimit). Aty ku kërkohen punimet apo shërbimet me qëllim që të zbatohet plani apo projektimi, atëherë kontrata për ekzekutimin e shërbimeve apo punimeve duhet të jepet veçmas.*

Në këtë aktivitet të prokurimit AK ka përdorur konkurs projektimi duke përfshirë edhe shërbimet e mbikqyrjes së realizimit të projektit. Kjo vërehet tek FDT, pika 28.2 shërbimi i projekteve, ku oferta financiare për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për projektin peshohet me 20%. Vlen te theksohet se AK edhe në vendimin nr.. 2023/ 0607 të OSHP-se të datës 31.10.2023 është rekomanduar që këtë çeshtje ta ketë në konsideratë.

Shpërblimi i projekteve	28.2	Oferta teknike (projekti) 60% Oferta financiar e projektit (çmimi) **20%** **Oferta financiar, çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit**

		projektin e ofruar te gjykatës Themelore Pejë 20 % **Totali = 100 Pikë**

Gjatë vlerësimit të këtij aktiviteti është vërejtur se paramasa dhe parallogarisa si pjesë përmbajtëse e projektit ideor pika 8 që do të specifikonte koston e përafërt të projektit nuk është dorëzuar nga OE ankues. Andaj konsideroj se kjo paraqet mangësi substanciale nga OE ankues.

Tutje, Eksperti teknik ka vërejtur se Raporti i vlerësimit i përgatitur nga Komisioni profesional i datës 20.11.2023 është një raport që paraqet vetëm poentim të përgjithësuar për OE, ky raport paraqet piket vetëm për kriteret dhe jo edhe për nënkriteret, nuk është një raport i cili përmban pjesen narrative ne lidhje me diskutimet dhe vlerësimet e projekteve ku në mënyrë të detajuar do të ishin paraqitur shpjegime në lidhje me poentimin për kriteret e caktuara per OE. Një vlerësim i tille e vështirëson rishikim e raportit të vlerësimit dhe analizimin e sakt të poentimit të bërë per OE.

Gjate procesit te ri-vlerësimit Autoriteti Kontraktues nuk është siguruar që identiteti i OE-ve të mos zbulohet duke ju ndryshuar kodet para prezantimit para jurisë profesionale. Pra në këtë pr,oces nuk është zbatuar parimi i anonimitetit te pjesëmarrësve në proces, pasi që juria profesionale për disa OE vetëm se i kishte të njohur identitetin e tyre. Zbulimi identitetit të operatorit ekonomik është në kundërshtim me neni 80 paragrafi 3 të LPP-së i cili saktëson se "Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kritereve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit. Identiteti i pjesëmarrësve nuk do të zbulohet para anëtarëve të jurisë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik/shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që te anuloje në tërësi këtë aktivitet të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"Europrojekt Plus" SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi

Taulant Ahmeti